

V E N D I M

Nr. 31, datë 06.04.2022

“PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 158, DATË 26.12.2019, TË KËSHILLIT
BASHKIAK, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË
QYTETIN E TIRANËS”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat “c” dhe “ç”, dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja “b”, nenit 34, pika 4, nenit 54, shkronja “f” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 145, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave “Për kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për dhënien e lejes së ndërtimit për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësisë natyrore, për përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë”, shkresës me nr. 662 prot., datë 28.04.2021, (protokolluar pranë bashkisë Tiranë me nr. 17562 prot., datë 28.04.2021), nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, rekomandimit të auditit të brendshëm të Bashkisë Tiranë dërguar me nr.prot 20391/4 datë 01.09.2021, protokolluar nga Agjencia e Shërbimit Funeral me nr.prot.370/4, datë 03.09.2021, si dhe në vijim të shkresës nr. 702 prot., datë 22.09.2021 (protokolluar me nr. 36505/1, datë 12.10.2021), nga Agjencia e Shërbimit Funeral, si dhe në vijim të memos nr.prot 12266, datë 30.03.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

Në vendimin nr. 158, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të ndryshuar, bëhen disa shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

1. Në nenin 26, “Përjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “d”, me përmbajtje si më poshtë:
“d. investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile”.
2. Në nenin 44, pika 4, në Aneksin 7 “Tarifa e parkimit”, zonat e administrimit të parkimit (ZAP) në qytetin e Tiranës ndryshojnë sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Në nenin 58 “Baza, niveli dhe përlllogaritja e tarifës”, në pikën 1, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë:
“1. Në rastin e refuzimit të lejes, tarifa i kthehet aplikuesit.
4. Kreu VII, Titulli I “Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël”, shfuqizohet.
5. Kreu V, Titulli II “Tarifa e shërbimit veterinar”, shfuqizohet.

6. Në nenin 59, "Tarifat për Agjencisë e Parqeve dhe Rekreacionit", pikat 1 dhe 8 ndryshohen si më poshtë vijon:

"1. Biletat për hyrjen në kopshtin zoologjik, janë:

- a. për të rritur:
 - o tarifë e plotë 300 lekë;
 - o tarifë e pjesshme 200 lekë;
- b. për fëmijë deri në 12 vjeç:
 - o tarifë e plotë 200 lekë;
 - o tarifë e pjesshme 100 lekë.
- c. për grup deri në 5 persona:
 - o tarifë e plotë 1200 lekë;
 - o tarifë e pjesshme 800 lekë".
- d. Për grup mbi 10 persona (fëmijë deri në 14 vjeç)
 - o tarifë e plotë 100 lekë

"8. Tarifat për dhënien në përdorim të fushave sportive në Parkun e Madh të Liqenit Artificial:

- a. Fusha e tenisit "Perlat Vushtina" (PMLAT):
 - o tarifë për individ/grup individësh 1600 lekë/kohëzgjatja 60 min;
 - o tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 2000 lekë/kohëzgjatja 60 min.
- b. Fusha e volejbollit (PMLAT):
 - o tarifë për individ/grup individësh 1400 lekë/kohëzgjatja 60 min;
 - o tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 2000 lekë/kohëzgjatja 60 min.
- c. Fusha e basketbollit (PMLAT):
 - o tarifë për individ/grup individësh 1300 lekë/kohëzgjatja 60 min;
 - o tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 2000 lekë/kohëzgjatja 60 min.
- d. Fusha e futbollit bar natyral (PMLAT):
 - o tarifë për individ/grup individësh 2000 lekë/kohëzgjatja 90 min;
 - o tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 2500 lekë/kohëzgjatja 90 min".

7. Pas pikës 8, shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

"9. Tarifat për dhënien në përdorim të Fushës Sportive të Futbollit Laprakë":

- o tarifë për individ/grup individësh 5000 lekë/kohëzgjatja 90 min;
- o tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 6000 lekë/kohëzgjatja 90 min;

8. Në nenin 61, "Lehtësira dhe përjashtime", pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë vijon:

"3. Nuk aplikohen tarifa për aktivitetet sociale me interes publik në Fushat Multisportive, Teatri Veror dhe Reja, ambientet e Tirana Olimpik Park dhe ambientet e shërbimit në Kopshtin Zoologjik në rastet e bashkëpunimit ose organizime të APR me të tretë ose nisma të Bashkisë Tiranë, ente arsimore publike, evente nga subjekte me mision bamirësie ose individe me aftësi të kufizuara apo nën përkrahje sociale (kur kjo vërtetohet me anë të një kërkesë me objekt: zhvillim aktiviteti social me interes publik nga subjekti organizues)".

"4. Për shërbimet e ofruara nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, studentët tarifohen me 50% të pagesës, pas paraqitjes së kartës së studentit".

9. Në nenin 62, Aneksi nr. 10 "Tarifat e shitjes së bimësisë", zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër dhe emërtim, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

10. Në pikën 1, të nenit 74, togfjalëshi "350 lekë", zëvendësohet me togfjalëshin "485 lekë".

11. Në nenin 75 "Baza dhe niveli i tarifës", pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

"3. Përjashtohen nga tarifat e shërbimit funeral personat që jetojnë në kushtet e varfërisë, të braktisjes, të mungesës së interesit mes anëtarëve të familjes, ose për të cilët është e pamundur të identifikohen familjarë që bartin detyrimin, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9220, datë

15.04.2004 "Për administrimin e shërbimit të varrimit".Procedura, kriteret dhe dokumentacioni për të përfituar nga ky përjashtim do të miratohen me urdhër të kryetarit të Bashkisë.

12. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Agjencia e Parqeve Rekreacionit, Tirana Parking, Agjencia e Shërbimeve Funerale, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Agjencia e Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

ZV/KRYETAR

VJOLLCA BRAHO



Zonat e Administrimit të Parkimit (ZAP) në qytetin e Tiranës

Zona 1.

Me kufij vijën kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Veri/Perëndimore, bulevardin "ZOG 1" në anën Lindore dhe kordonin hyrës me rrugët "Lazi Miho", "Konferenca e Pezës" duke vazhduar përgjatë bulevardit "Gjergj Fishta" në anën jugore, deri në ndërprerjen me bulevardin "Dëshmorët e Kombit"

Zona 2.

Me kufij zonën përgjatë bulevardit "ZOG 1" në pjesën perëndimore, vijën kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Veri/Lindore dhe zgjatimin e bulevardit "Zhan D'Ark" deri në vijën kufizuese në anën Jugore.

Zona 3.

Me kufij segmentin e bulevardit "Dëshmorët e Kombit" në anën perëndimore, bulevardin "Bajram Curri" dhe përgjatë lumit të Lanës deri në vijën kufizuese në anën veriore dhe vijën kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Jug/Lindore.

Zona 4.

Me kufij kordonin hyrës përgjatë rrugës "Konferenca e Pezës" në anën veriore, bulevardin xxxxx si vijë kufizuese të qytetit të Tiranës në anën lindore, Zona Lindore përgjatë bulevardit "Dëshmorët e Kombit" dhe vija kufizuese e qytetit në pjesën Jugore.

Zona 5.

Me kufij të njësisë administrative Dajt

Zona 6.

Me kufij të njësisë administrative Zall Bastar

Zona 7.

Me kufij të njësisë administrative Shëngjergj

Zona 8. Me kufij të njësisë administrative Farkë

Zona 9.

Me kufij të njësisë administrative Petrelë

Zona 10.

Me kufij të njësisë administrative Bërzhitë

Zona 11.

Me kufij të njësisë administrative Kërrabë

Zona 12.

Me kufij të njësisë administrative Baldushk

Zona 13.

Me kufij të njësisë administrative Pezë

Zona 14.

Me kufij të njësisë administrative Vaqarr

Zona 15.

Me kufij të njësisë administrative Ndroq

Zona 16.

Me kufij të njësisë administrative Kashar

Zona 17.

Me kufij të njësisë administrative Zall Herr

Aneksi nr. 10: Tarifa për shitjen e bimësisë

Nr.Rendor	Emërtimi	Vitet e prodhimit	Tarifa e shitjes/njësi
1	Drurë Dekorativë	Viti I	719
2	Drurë Dekorativë	Viti II	914
3	Drurë Dekorativë	Viti III	1,612
4	Drurë Dekorativë	Viti IV	3,214
5	Drurë Dekorativë	Viti V	4,288
6	Drurë Dekorativë	Viti VI	6,028
7	Shkurre Dekorative	Viti I	720
8	Shkurre Dekorative	Viti II	966
9	Shkurre Dekorative	Viti III	1,756
10	Shkurre Dekorative	Viti IV	3,632
11	Lule sezonale		20
12	Lule sezonale në vazo		204
13	Lule të freskëta		228
14	Lule të freskëta (Sterlicie Tulipanë, Zymbyl, Gladiol, Dahlia, Kalla, Lilium)		233
15	Asparagus		132
16	Lule shumëvjeçare(gerbera,Krizanteme,pehonje)		199
17	Lule në vazo shtuar me kalema		605
18	Lule në vazo shtuar me fare		720